

**Fjala e Presidentit të Republikës Sh. T. Z. Bujar NISHANI
në ceremoninë e 25-vjetorit të krijimit të Shërbimit Informativ të Shtetit**

*4 korrik 2016, ora 9.00
Institucioni i Presidentit të Republikës*

I nderuar Zoti Drejtor i Shërbimit Informativ të Shtetit,

I nderuar Zoti Zv/Ambasador i SHBA,

Të nderuar drejtues dhe punonjës të vendeve mike,

Të nderuar pjesëmarrës!

Jemi mbledhur në këtë ceremoni të veçantë dhe kaq të rrallë për të nderuar Shërbimin Informativ të Shtetit, për më tepër punën, përpjekjet, sakrificat, arritjet e sukseset në vijimësi të këtij Institucioni kaq të rëndësishëm për forcimin e shtetit shqiptar, të sigurisë së tij e të qytetarëve të vendit, por edhe për partnerët dhe aleatët tanë strategjikë.

Kjo ceremoni e thjeshtë, por solemne nuk u organizua rastësisht sot, në një nga ditët e para të korrikut, përkundrazi ka një arsye të vërtetë e të rëndësishme. Sigurisht është një koincidencë e këndshme që sot është data 4 korrik, një nga ditët më të rëndësishme në historinë amerikane dhe botërore të përpjekjeve vigane për liri e demokraci.

Vendi ynë rihyri në këtë rrugë të ndritur të lirisë dhe demokracisë njëzet e pesë vjet më parë, kur më 2 korrik 1991, përfaqësuesit parlamentarë pluralistë të zgjedhur nga qytetarët shqiptarë miratuan ligjin për “Krijimin e Shërbimit Informativ Kombëtar.”

Ai ligj ishte ndër të parët që hartoi dhe miratoi Parlamenti ynë i parë pluralist pas gati një gjysmë shekulli tirani. Miratimi i tij ishte një arritje e madhe, një fitore tepër e rëndësishme e forcave demokratike e përparimtare të Shqipërisë, e cila ndërkohë po dilte nga errësira e ftohtë e diktaturës komuniste.

Me miratimin e këtij ligji mbaroi zyrtarisht edhe periudha e zyrtë, e dhunshme e kriminale e Sigurimit famëkeq të Shtetit. Për herë të parë në historinë moderne të vendit tonë, shërbimi sekret nisi të kryente punën e tij, bazuar në një dokument ligjor. Deri atëherë Sigurimi ogurzi kishte funksionuar pa ligj. Njëloj udhëzimi që ekzistonte me emrin “Platformë” nuk ishte dokument shtetëror, por partiak, thellësisht e tërësisht politik dhe i ideologjizuar.

Është e njohur shprehja se “nëse shërbimet e fshehta nuk e bazojnë veprimtarinë e tyre në ligj, ata nuk kanë ndonjë ndryshim nga organizatat kriminale”. Kjo shprehje është më se e vërtetë për ish-Sigurimin e Shtetit, i cili funksiononte si një organizatë mafioze, duke ushtruar pambarimisht dhunë mbi qytetarët e këtij vendi e duke ngjallur e mbajtur të ngrehur një klimë terrori e pasigurie të përgjithshme e të pandërprerë, duke sajuar pafundësisht armiq, lufta ndaj të cilëve ishte e vetmja formë energjie që mbante gjallë diktaturën, diktatorin dhe shpurën e tij.

Duke funksionuar prej 25 vjetësh bazuar në ligj, SHISH-i ia ka arritur të jetë një institucion informativ, i depolitizuar dhe modern, i cili e ka kryer dhe e kryen veprimtarinë e tij në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjet e Republikës së Shqipërisë, në përmbushje të misionit tij në funksion të sigurisë kombëtare të vendit, ruajtjes së integritetit, pavarësisë dhe rendit kushtetues.

Vendi ynë ka pësuar transformime të mëdha politike e shoqërore, ka ecur seriozisht në agjendën e integritimeve euro-atlantike, është anëtar me të drejta të plota në NATO dhe vend kandidat për në Bashkimin Evropian.

Sfidat dhe kërcënimet me të cilat përballen shërbimet e inteligjencës, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe strukturat e tjera shtetërore të sigurisë kanë evoluar dhe janë sofistikuar duke u shtuar ashtu siç jemi të gjithë dëshmitarë të sulmeve të përgjakshme terroriste në çdo cep të botës së qytetëruar.

Përveç kërcënimeve tradicionale, SHISH-i si agjencia kryesore informative në vendin tone, përballet edhe me dukuri të një natyre tjetër si terrorizmi, krimi i organizuar që cenon sigurinë kombëtare, ekstremizmi i dhunshëm, veprimtaria e shërbimeve kundërshtarë të Shqipërisë dhe Aleancës së Atlantikut të Veriut, siguria rajonale, prodhimi dhe trafikimi i lëndëve narkotike, krimi kibernetik, krimet kundër mjedisit, emigracioni i paligjshëm, etj.

Në luftën ndaj këtyre fenomeneve, këtyre rreziqeve dhe kërcënimeve, ju zonjat dhe zotërinjtë e të gjithë komunitetit të zbulimit në SHISH keni punuar me përkushtim, profesionalizëm dhe me sakrifica, duke qëndruar në vijën e parë të frontit për të organizuar operacione të fshehta dhe siguruar informacion të vlefshëm, objektiv dhe të vërtetë për politik-bërësit dhe vendim-marrësit në Republikën e Shqipërisë.

Për këtë kontribut të paçmuar gëzoni vlerësimin maksimal dhe përkrahjen e palëkundur të Presidentit të Republikës. Për këtë, si dhe për vazhdimësinë e këtij besimi dhe përkrahjeje të pakursyer mund të jeni më se të sigurt edhe në të ardhmen e afërt e të largët.

Për punën e palodhur, angazhimin e vazhdueshëm maksimal dhe profesional që keni demonstruar në vite, për sakrificat në disa raste edhe të skajshme si dhe privimet personale e familjare, përfitoj nga rastin që t'ju përgëzoj ju, stafin drejtues e administrues të SHISH-it, të gjithë punonjësit e Institucionit tuaj në qendër dhe në bazë, si dhe familjet tuaja për qartësinë, durimin e mirëkuptimin që kanë treguar si dhe për mbështetjen e pandërprerë morale që ju kanë dhënë e ju japin në realizimin me sukses të misionit tuaj të vështirë e fisnik njëkohësisht.

Sukseset tuaja nuk bëhen publike, gabimet ndoshta po, por kjo është natyra e punës së zbulimit dhe informimit. Puna që ju keni bërë, puna që ju bëni sot dhe puna që do të bëni në të ardhmen është me rëndësi themelore për sigurinë e vendit tonë dhe për sigurinë e partnerëve dhe aleatëve tanë në të tashmen dhe në të ardhmen, prandaj ajo është e vlerësuar maksimalisht nga unë si President i Republikës.

Punonjësit dhe drejtuesit e SHISH-it, prej vitesh kanë ditur që të edukojnë vetveten, duke krijuar një institucion realisht të depolitizuar, e që njëkohësisht, e në vijimësi, të jetë kontribuues dhe bashkëpunues në shpërndarjen dhe menaxhimin e informacionit me organizmat dhe institucionet e tjera të ngjashme, apo të zbatimit të ligjit në Republikën tonë.

Globalizimi dhe lëvizja e lirë, si fenomene e si akte zhvillimi jetike e gjithëpërfshirëse të kohës së sotme, ashtu siç pritej, kanë sjellë me vete edhe problematikat e tyre, siç janë bashkëpunimi rajonal e më gjerë i krimit të organizuar, i individëve dhe grupeve në mbështetje të veprimtarive radikale apo terroriste, i organizatave kriminale, grupeve të trafikut të drogës, pastrimit të parave, etj.

Shumica e risive teknologjike që shërbejnë për komunikim të shpejtë, për shoqërizim të menjëhershëm të ideve, apo për përhapje planetare të qëndrimeve të caktuara ndaj ngjarjeve dhe fenomeneve, janë në pronësi apo përdorim të të gjithëve. Ende nuk ka, dhe ndoshta edhe për shumë kohë nuk do të ketë një mënyrë, që prej tyre të përfitojnë vetëm “të mirët”, ndërsa “të këqijtë” të mos e kenë këtë akses.

Nga ana tjetër, ajo çfarë përpara disa vitesh ishte apo konsiderohej sekret, sot ndoshta është informacion publik dhe i hapur në internet, në medien e shkruar dhe elektronike, në medien sociale, etj. Dimensioni teknologjik i informacionit ka pësuar ndryshime të jashtëzakonshme.

Vite më parë, në kohën e Luftës së Ftohtë, para epokës së bumit teknologjik, e gjithë përçapja e shërbimeve të fshehta ishte të kërkonin e gjenin informacionin e fshehtë, sekret e të rëndësishëm, në një terren ku në përgjithësi kishte mungesë tërësore të dhënash. Ndërsa në ditët e sotme përveç kësaj detyre, po kaq e rëndësishme është të jesh në gjendje të qëmtosh e të veçosh informacionin e duhur e të nevojshëm, nga moria e paanë e informacioneve që lundrojnë nëpër faqet e pafund të internetit.

Jam i bindur dhe koha ka treguar se ju e dini se detyra dhe sfida juaj është që zhvillimeve bashkëkohore shoqërore, ekonomike, politike dhe teknologjike t'i përgjigjeni me mjetet dhe instrumentet e duhur ligjorë, me forma dhe metoda të avancuara të punës, me përditësim teknologjik, me bashkëpunim ndër-institucional, dypalësh e ndërkombëtar, por pa harruar asnjëherë dimensionin njerëzor.

Sado që të përparojë shoqëria dhe teknologjia, ju gjithmonë do të mbështeteni tek burimet njerëzore. Ata janë çelësi i suksesit, qoftë për sigurimin e informacionit unik që nuk mund të sigurohet në asnjë mënyrë tjetër, përveçse nëpërmjet veprimtarisë së fshehtë të shërbimeve të inteligjencës, qoftë për të vënë në lëvizje e për tu marrë maksimumin mjeteve të teknologjisë moderne.

Për t'u përballur me sfidat e kohës, SHISH-i gjithashtu ka nevojë për mbështetje financiare, për buxhet më të lartë dhe për dhe resurse të tjera për t'u përditësuar me të rejtat e teknologjisë dhe për të plotësuar nevojat e domosdoshme për realizimin me sukses të detyrave ligjore, prioriteteve dhe misionit të tij.

SHISH-i ka dhe do të ketë gjithmonë nevojë për punonjës atdhetarë të përkushtuar, të talentuar, të motivuar dhe të gatshëm për të sakrifikuar për realizimin me sukses të misionit të tij.

Në funksion të këtij qëllimi, SHISH-i ka vazhduar të mbështesë punonjësit më të mirë, ka ndjekur procedura profesionale në përzgjedhjen e të rinjve, ka nxitur karrierën dhe ka ofruar mundësi të barabarta avancimi duke u bazuar në punën dhe rezultatet e larta të punonjësve të tij.

Kur u krijua SHISH-i në vitin 1991, vendi, ende endej në humbëtirën e vetmisë e të vetë-izolimit, aq më shumë kufoma e Sigurimit të Shtetit.

Sot pas 25 vjetësh, SHISH-i ia ka dalë mbanë të ketë bashkëpunim dy dhe shumëpalësh me shumë shërbime dhe agjenci sekrete për fushat me interes reciprok.

Shkëmbimi i informacionit, i analizave dhe vlerësimeve, bashkëpunimi informativ dhe operativ me shërbimet partnere është një vlerë e shtuar, plotëson tablonë informative, rrit besueshmërinë e SHISH-it dhe kontribuon në parandalimin dhe goditjen e veprimtarive të paligjshme.

SHISH-i ka bashkëpunim operacional optimal dhe strategjik të vlerësuar, me shërbimet informative te vendeve mike, si dhe është një kontribuues dhe partner i vlerësuar për ekspertizën e tij në komunitetin dhe strukturat e inteligjencës në NATO.

Është kënaqësi për të gjithë ne kur mësojmë se SHISH-i ka marrë gjithashtu vlerësimet më të larta nga shërbimet partnere strategjike për luftën kundër terrorizmit, për kontributin në sigurinë rajonale, për bashkëpunimin me strukturat e inteligjencës në NATO, duke u bërë kështu një partner profesional dhe i besueshëm dhe duke kontribuar në sigurinë kombëtare, rajonale e më gjerë.

Gjej rastin gjithashtu, të përgëzoj Drejtorin dhe ekipin udhëheqës të SHISH-it për aftësitë administruese, për drejtimin me ligjshmëri dhe profesionalizëm, për nxitjen dhe motivimin e punonjësve, për frymën e punës në ekip, duke respektuar rregullat e sekretit dhe përkushtimin në realizimin e detyrave dhe përparësive të Institucionit.

**I nderuar Zoti Drejtor Visho Ajazi Lika,
Drejtues të niveleve të ndryshme të SHISH-it,
Të dashur punonjëse dhe punonjës të Shërbimit!**

Duke analizuar e vlerësuar veprimtarinë e SHISH-it, punën e kryer nga punonjësit e këtij Institucioni thelbësor, guximin, qëndrueshmërinë, besnikërinë ndaj vendit, Kushtetutës e ligjit, arritjet e shumta e tepër të vlefshme në përballjen me rreziqet dhe kërcënimet shumëplanëshe ndaj sigurisë sonë kombëtare, në cilësinë Presidentit të Republikës, kam vendosur që të nderoj e të vlerësoj me merita të plota këtë Institucion me “Dekoratën e Artë të Shqiptarëve”.

Përgëzime për dekoratën e lartë! Urimet më të mira në punën tuaj. Unë jam i ndërgjegjshëm dhe e di se sfidat që kemi përpara dhe me të cilat përballlemi nuk janë të lehta, por po ashtu jam i bindur se ju do ja dilni mbanë. Ne kemi punuar dhe do të punojmë të gjithë së bashku në përballje me sfidat.

Le të bëjmë punë edhe më të mirë në shërbim të qytetarëve të vendit tonë, kombit shqiptar dhe partnerëve tanë strategjikë.

Dua t’ju siguroj edhe një herë se Presidenti i Republikës dhe Institucioni i tij, në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve të vendit, do të vazhdojë të mbështesë fuqimisht SHISH-it dhe punën e tij në të ardhmen.

Ju faleminderit!